

Angazhohu Monitoro Vepru



SUPLEMENT I GAZETËS NOSITI NGA GRUPI MONITORUES I TË RINJVE POGRADEC, JANAR 2014

*Komunitetet që u përgjigjen në mënyrë efektive problemeve,
sfidave dhe oportuniteteve që u dalin përpara,
janë të prirura drejt një demokracie të vërtetë*

Michael K. Briand



- VULLNETARIZMI	faqe 2
- MONITORIMI I KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC.....	faqe 3
- MITE DHE REALITETE	faqe 4
- PROJEKTI “ NJË SY PËR MJEDISIN”	faqe 5
-ESE - REPORTAZHE - LAJME NGA TË RINJTË	faqe 6 & 7
-TA PASTROJMË SHQIPËRINË NË NJË DITË.....	faqe 7
-BOTIME TË SHOQATES “UNË, GRUAJA”	faqe 8



VULLNETARIZMI

Kush është një vullnetar?

Vullnetar është dikush i cili është i gatshëm që kohën, aftësitë dhe dijet e tij t'i përdorë për një aktivitet ose një organizatë, e cila punon për të përmirësuar komunitetin. Zakonisht një vullnetar nuk merr asnjë pagesë për punën e tij. Si rezultat, puna bëhet në një kohë të pjesshme, dhe jo me kohë të plotë pune, edhe pse angazhimi për kohën e shërbimit do të varet nga dëshirat individuale të vullnetarit dhe disponueshmërisë.

Çfarë bën një vullnetar?

Nuk ka një punë të vetme më të cilën mund të përshkruash punën e vullnetarit. Puna mund të ndryshojë duke u varur nga problemi i adresuar nga organizata që drejton punën, dhe aftësitë personale të vullnetarëve. Një vullnetar mund të mbledhë plehra, të ndërtojë shtëpi, të mësojë fëmijët, të ofrojë shërbime mjekësore, ose shumë gjëra të tjera.

Ata kujdesen për një çështje në komunitetin e tyre dhe duan të ndihmojnë për të përmirësuar atë:

- Kjo u jep atyre ndjenjën e qëllimit.
- Ajo u lejon atyre të fitojnë aftësi të vlefshme si përvojë pune-teknike, aftësitë e komunikimit, etj.
- Kjo do të përmirësojë rininë e tyre.
- Kjo i lejon ata të punojnë në një fushë që iu intereson, por në të cilën ata nuk janë të punësuar.
- Ajo u lejon atyre të takohen me njerëz të rinj në komunitet.
- Një organizatë apo projekt i ka kërkuar ata për të ndihmuar sepse nuk kanë mjaft anëtarë të stafit për të kryer qëllimet dhe objektivat e tyre.
- Ajo është e bukur!

Kujto, asnjë nga këto arsye nuk është më e mirë se të tjerat. Gjëja më e rëndësishme është gadishmëria jote për ta bërë punën.

Si të filloj të punoj si vullnetar?

Nëse mendon se dëshiron të punosh si vullnetar, duhet të fillosh të mendosh për komunitetin apo vendin ku ti dëshiron të punosh. Identifiko disa nga problemet që duan më shumë ndihmë. Më pas zgjidh një (ose më shumë) nga këto probleme që ti mendon se do të të pëlqente të punoje.

Pasi ke vendosur për llojin e punës që të pëlqen të bësh, hapi tjetër do të jetë identifikimi i organizatës apo njerëzve në komunitetin tënd që mund të jenë gati të punojnë për këtë problem. Këto organizata dhe njerëz zakonisht duhet të kenë disa resurse ose informacion që ti ke nevojë të punosh suksesshëm. Duke punuar së bashku do të jeni në gjendje të kompletoheni më shumë dhe do të ketë më shumë gjasa të dyfishohen përpjekjet.

Nëse komuniteti juaj nuk ka asnjë që punon për çështjen që keni zgjedhur ose nëse doni të çoni përpara punën tuaj duhet të mendoni çfarë lloj aktivitete mund të bëni në mënyrë që të adresoni këtë problem. Ju duhet gjithashtu të identifikoni njerëz apo grupe të tjerë që mendoni se mund të jenë të interesuar t'ju ndihmojnë në punën tuaj. Pasi keni bërë këtë, bëni një plan të këtyre aktiviteteve, planifikoni kohën dhe vendin, thuajani të gjitha atyre që mendoni se do të jenë të interesuar!

Është e rëndësishme që të mbahet ndërmend se puna vullnetare nuk është gjithmonë e thjeshtë. Nëse përpiqeni të bëni shumë, shpejt ju mund të dekurajoheni nga mungesa e ndryshimit dhe të largoheni nga puna para se të keni shansin të jeni efektiv.

Mbaj shënime për punën tënde

Nëse filloni të punoni si vullnetar, duhet të mbani shënime për punën. Këto shënime mund të përdoren si provë për t'i treguar punëdhënësit të ardhshëm ose shkollës punën që keni bërë. Ato janë gjithashtu të vlefshme për ju, kështu mund të kujtoni eksperiencën tuaj gjatë vullnetarizmit.

Disa nga informacionet bazë rreth punës që duhet të mbani në këto shënime përfshijnë: Datën, kohën, vendin, organizatën sponsorizuese, një përshkrim të shkurtër të detyrave të bëra dhe firmën e një prej shefave, për të verifikuar punën e bërë atë ditë. Ju gjithashtu mund të shkruani reflektime personale rreth punës si vullnetar.

Mbani shënime për evente apo ide që ju kanë lënë përshtypje gjatë punës, si psh sfidat, gjërat që keni mësuar, ose gjëra që mund të përmirësoni në të ardhmen. Ky informacion mund t'ju ndihmojë të fitoni më shumë nga përvoja juaj vullnetare dhe gjithashtu mund të përdoret kur ju jeni duke shpjeguar rëndësinë dhe ndikimin e punës tuaj për punëdhënësit të ardhmen apo shkolla.

Provoje!

Puna vullnetare mund të përmirësojë komunitetin dhe mund të bëhet vërtet e dobishme për vetë vullnetarët, por nuk është vetëm modeli i punës që do të punojë çdo person. Mënyra më e mirë për të mësuar si dhe ku doni të veni vullnetar është ta provoni vetë. Provoni punë dhe orare të ndryshme dhe do të gjeni sistemin e punës që është më i mirë për ju.

Kontakttoni me shoqatën "Unë, Gruaja" në Pogradec dhe angazhohuni edhe ju.

Tel. 0832140

www.facebook.com/pages/Shoqata-Une-Gruaja/



MONITORIMI I KËSHILLIT BASHKIAK POGRADEC

Në kuadër të projektit “Angazhohu-Monitoro-Vepro”, grupi i të rinjve dhe vullnetarëve pranë shoqatës “Unë, Gruaja”, morën pjesë në monitorimin e mbledhjes së radhës të Këshillit Bashkiak.

Në këtë mbledhje u diskutua për projekt-vendimin mbi dhënien e ndihmës ekonomike, projekt-vendim për largimin nga lista e të pastrehëve të familjeve që kanë përfituar kredi me kushte lehtësuese, dhënia e bursave për nxënësit dhe studentët dhe shumë interesante shpallja “Qytetar Nderi” i zotit Frieder Heinz Weinhold, historia e të cilit fillon prej shumë kohësh në Shqipëri.

Të rinjtë e interesuar për këtë mbledhje mësuan se si funksionon Këshilli Bashkiak dhe se në ç’mënyrë familjet në nevojë përfitojnë nga ndihmat ekonomike dhe si nxënësit që nuk kanë mundësi ekonomike për shkollim, përfitojnë nga bursat e dhëna nga bashkia. Integrimi i tyre në këtë fushë të jetës i përgatit ata të njihen më seriozisht me funksionimin e qeverisë, e cila ndikon në jetët e secilit prej nesh. Këta të rinj u njohën edhe me përfaqësuesit e Këshillit Bashkiak dhe me drejtuesit e tyre si dhe kuptuan rëndësinë e transparencës së këtyre mbledhjeve.

Në bazë të raporteve që nxënësit nxorrën nga kjo mbledhje, u miratuan projekt-vendime shumë të rëndësishme lidhur me dhënien e ndihmave ekonomike, ndarjen e bursave për nxënësit dhe studentët në nevojë, etj. Për periudhën 1 deri 30 tetor, qytetarët nuk e morën ndihmën ekonomike. Kryetari i Këshillit Bashkiak, z. Eduart Kapri, foli me kolegët e tij n.q.s do të miratohesh apo jo për 3 muajt e kaluar, marrja e ndihmës ekonomike, duke e dhënë atë në



fund të muajit dhjetor 2013 ose në fillim të muajit janar 2014. Pas një konsultimi të gjatë, ranë dakort që të jepej ndihma ekonomike për 3 muajt e kaluar dhe për 3 muajt e ardhshëm të vitit 2014. Me këtë miratim u pajtuan të gjithë përfshirë këtu edhe Kryetarin e Bashkisë, zotin Artan Shkëmbi.

Një projekt-vendim tjetër që u miratua ishte marrja e kredive për të pastrehët. Për këtë projekt-vendim nuk u diskutua shumë pasi të gjithë ranë dakort menjëherë. Personat e pastrehë do të përfitojnë kredi pa interes. Ndryshimi në dhënien e kësaj kredie ishte heqja e interesit pasi një vit më parë këto kredi jepeshin me disa kriteret të cilat këta të pastrehë nuk i përballonin dot pasi ishin me përqindje interesi të lartë për këtë kategori.

Një projekt-vendim, i cili i tërhoqi më shumë vëmendjen grupit të të rinjve ishte dhënia e bursave për nxënësit ekselentë por në vështirësi ekonomike, si për nxënësit e shkollave të mesme ashtu edhe atyre parauniversitar. Bursa të plota dhe gjysëm bursa iu dha nxënësve që i meritonin dhe që kishin nevojë. Numri i bursave për arsimin e lartë ishte 32 ndërsa numri i bursave për arsimin parauniversitar ishte 1.

Edhe nxënësit me një prind dhe me probleme sociale morën bursa të plota dhe të tillë ishin 4.

Kryetari i Bashkisë, zoti Artan Shkëmbi tha se bursat janë për ata studentë të mirë të cilët kanë nevojë të ndihmohen nga ana ekonomike pasi familjet e tyre të varfra nuk i përballojnë dot shpenzimet e shumta që duhen për të shkolluar fëmijët e tyre. Këta studentë duhet të ecin përpara dhe bursa është një stimulim i mëtijshëm që ata t’i japin edhe më shumë rëndësi shkollës dhe arsimit. Gjithashtu ai tha se mundësi iu dha edhe atyre nxënësve shumë të mirë, të cilët edhe pse nuk kanë bërë kërkesë për marrjen e bursës janë të mirëpritur. Ai tha se sa më shumë nxënës të jenë ekselentë aq më i nderuar do të jetë qyteti ynë.

Projekt-vendimi i fundit por jo më pak i rëndësishëm, përkundrazi shumë interesant, ishte dhënia e titullit “Qytetar Nderi” i zotit Friederich Heinz Weinhold. Historia e zotit

Weinhold lidhur me Pogradecin, fillon që shumë herët dhe ishte shumë interesante pasi edhe pse e ka vizituar Shqipërinë për herë të parë në një kohë shumë të vështirë tranzicioni, sipas Kryetarit të Bashkisë, ai u tregua një mik shumë i mirë i qytetit tonë duke u rikthyer pas shumë vjetësh dhe duke kontribuar shumë në institucionet arsimore, shëndetësore, etj.

Zoti Weinhold ka lindur në Gjermani dhe është kryetar i bordit si dhe drejtor i një shoqate të huaj. Ai ka treguar një frymë humanizmi me veprimtarinë e tij të bamirësisë për 20 vjet. Kontributi i tij i veçantë ka qënë në vitin 1999 gjatë luftës së Kosovës për refugjatët kosovarë në Pogradec.

Dhënia e këtij titulli ishte shumë e rëndësishme dhe zoti Weinhold i falenderoi të gjithë. Fjalët e tij ishin këto: -Nuk kisha dyshim se kjo mbledhje dhe votimet që u bënë, do të shkonin kaq mirë edhe po të mos isha prezent në këtë takim. Unë jam i lumtur që Pogradeci është në zhvillim dhe besoj se në bazë të këtij bashkëpunimi do të bëjmë edhe më shumë për këtë qytet. Shqipëria është më në zhvillim se Gjermania dhe për këtë më vjen mirë. Këtu jam i gatshëm që me kryetarin e bashkisë të bëjmë shumë gjëra në vazhdim.

Me miratimin e këtyre projekt-vendimeve shumë të vlefshme u mbyll kjo mbledhje e Këshillit Bashkiak duke iu dhënë mundësinë grupit të të rinjve të bëhen pjesë e transparencës dhe demokracisë.

TË RINJTË QË KANË MARRË PJESË NË MONITORIMIN E KËSHILLIT BASHKIAK

- | | |
|------------------|----------------------|
| 1. Blerina Qose | 6. Klediana Gjyli |
| 2. Andi Shkëmbi | 7. Kledi Gjyli |
| 3. Asja Leka | 8. Zarife Beçoku |
| 4. Tea Shkëmbi | 9. Doralda Tanellari |
| 5. Eriselda Paho | 10. Floresha Ali |

MITE DHE REALITETE

Miti -Teknologjitë e informacionit janë më të mira se ato të letrës

Mbetjet elektronike janë një nga problemet mjedisore gjithnjë në rritje

Letra është një element i domosdoshëm i qytetërimit dhe zhvillimit. Letra prodhohet nga materiale të riciklueshme, të ripërtërishme.

Komunikimi elektronik dihet që është eficient, por po ashtu dihet se jo gjithmonë është i qëndrueshëm.

Mendoni pak: Kompanitë e komunikimit duhet të sigurojnë burimet për lëndën e parë, të prodhojnë dhe të transportojnë produktet e internetit: serverat, kompjuterat, iPhones, etj. Më pas këto pajisje duhet të furnizohen me energji dhe ftohje, duke marrë energji elektrike nga sistemet lokale të prodhimit të energjisë, energji e cila prodhohet në mënyra të ndryshme, përfshi edhe uzinat që punojnë me qymyr.

P.sh. në Francë, sasia e gazit të emetuar në sera që vjen vetëm nga kërkimi në internet është i barabartë me 287 kiloton CO2

Kërkimet në google për gjatë një muaji janë të barabarta me 260 000 kg CO2, sasi me të cilën do të mund të furnizoheshin me energji mesatarisht 4,239 shtëpi për një muaj.

Teknologjitë IT emetojnë 0.86 metric gigatonnes në vit ose rreth 2% të emetimit në atmosferë për gjithë botën. Deri në 2020, llogaritet që të arrijë në rreth 3% të të gjithë emetimeve: 1.54 metric gigatonnes.

“Ju lutem mos e printoni këtë”, “Mbroni pemët: Printoni vetëm nëse është e domosdoshme,” ose “Ju lutem mendoni për mjedisin para se të printoni këtë email”, të gjitha janë mesazhe dashamirëse dhe përdoren gjerësisht në fund të emaileve me synimin e sinqertë për të ndihmuar planetin.

Ne i vlerësojmë dhe i përshëndesim të gjithë ata që janë të ndjeshëm për çështjet mjedisore. Por nuk ka asnjë të keqe nëse printon. Letra është e riciklueshme, ekologjike, mund të ripërdoret, lënda e parë e së cilës, druri, rikrijohet/ripërtërihet. Nga ana tjetër, prodhimi i një kompjuteri, mesatarisht kërkon nxjerrjen dhe përpunimin e disa dyzinave minerale dhe metale, përfshi ar, argjend dhe paladium, si edhe sasi të mëdha lëndësh plastike e përzjerje hidrokarburesh.

Sipas një studimi të UN, për të prodhuar mesatarisht 24-kilogram kompjutera dhe 27-centimetra monitorë nevojiten të paktën 240

Realiteti -Në kundërshtim me bindjen mjaft të njohur, aktivitetet online janë një nga kontribuesit kryesorë në ngrohjen globale

kilogram gas fosil, 22 kilogram kimikate dhe 1,500 kilogram ujë – ose 1.8 ton gjithsej, e barabartë me peshën e një rinoceronti. Jetëgjatësia e një kompjuteri është e shkurtër dhe elektronika është bërë burimi më i madh i mbetjeve në botë. Në fakt, në Evropë gjenerohen 10 milion ton mbetje elektronike në vit ku vtëm 2 prej tyre riciklohen. Letrën e kemi përdorur për rreth 2 mijë vjet dhe sistemi i transmetimit dhe ruajtjes së informacionit nëpërmjet letrës janë mëse të konfirmuar.

Ndërkohë që shpejtësia dhe hapësira e ndarjes së informacionit online janë të padiskutuara, ekspertët po zbulojnë se nëse dëshiron të mësosh diçka, në shumë raste kjo realizohet nëpërmjet materialeve të printuara.

Douglas Rushkoff, një profesor nga New School University, thekson se kur lexojmë nga kompjuteri nuk qëndrojmë dhe nuk u shkojmë gjërave në brendësi. Ne i hedhim një sy të shpejtë, shpesh duke bërë edhe ndonjë gjë tjetër dhe nuk arrijmë të asimilojmë aq sa duhet.

Sipas studimeve të Wayne State University, të lexuarit nga letra është aktualisht 10-30% më i shpejtë se të lexuarit online, pjesërisht sepse është më e lehtë



që lexuesi ta ndjekë se ku është në faqe. Një studim i Kembrixhit konkludoi se që të mësosh duhet të bësh një përmbledhje dhe që të bësh përmbledhjen duhet ta kuptosh temën në thellësi, gjë e cila është shpesh e vështirë të arrihet online.

Letra ende përdoret çdo ditë në të gjithë botën. Ne lexojmë gazeta, revista dhe libra, ne dëshirojmë që ato çka blejmë të jenë të pakitura mirë dhe çdo ditë na nevojitet letër për nevoja higjenike. Është fakt që për çdo lloj nevoje për komunikim ka impaktin e vet në mjedis. Ne konsumojmë energji dhe burime edhe kur dërgojmë email edhe kur dërgojmë letër. Nuk ka thjesht “përgjigje të drejtë” dhe nuk është çështja “informacion nga teknologjia apo nga letra”. Më shumë është çështja si këto të dyja do të plotësojnë njëra-tjetrën në mënyrë që të kenë impakt minimal në mjedis.

Përktheu: Majlinda Cake



Projekti “ Një sy për mjedisin” REDUKTO - RIPERDOR - RICIKLO

Mësues, prindër, nxënës - në ndihmë të riciklimit

Nxënësit dhe mësuesit e shkollës 9-vjeçare “Ptoleme Xhuvani”, Mëmëlisht kishin parë spotin televiziv të shoqatës “Unë, gruaja” dhe kontaktuan mësuesen Najada Mëngri me dëshirën për të mësuar më tej. Najada prej vitesh është një nga pikat e kontaktit të shoqatës “Unë, Gruaja dhe kryen aktivitete të ndryshme në këtë fshat duke çuar informacion për gratë, vajzat e të rinjtë, për Ligjin për dhunën në familje, mekanizmin e referimit të dhunës, vullnetarizmin e të rinjve dhe përfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje.

Ata u njohën me projektin për riciklimin e mbetjeve qëllimi i të cilit është sensibilizimi i komunitetit dhe vënia në jetë e këtij projekti madhor, me përfitim për të gjithë.

Në këtë nismë, një mbështetje e madhe u dha nga shoqata “Unë, Gruaja”. Kjo ndihmë konsistoi në dhurimin e materialeve të tilla si: postera, parulla, material ndihmës- mbështetës për ideimin dhe detajimin e projektit “Një sy për mjedisin”, fletëpalosje që dëshmojnë arritjet e projektit atje ku ai është zbatuar. Gjithashtu u pajisën nxënësit e shkollës me doreza plastike, thasë plastike për grumbullimin e mbeturinave si mbështetje nga ana e shoqatës.

Në takimin e organizuar me nxënës dhe prindër të tyre për këtë rast u theksuan përparësitë që sjell zbatimi i këtij projekti. Të gjithë u shprehën entuziastë dhe të gatshëm për t’u angazhuar plotësisht në zbatimin e këtij projekti, që për të arritur qëllimin e tij, kërkon edhe përfshirjen me përgjegjësi të pushtetit vendor.

Angazhimet e përbashkëta:

- Me dëshirën e tyre nxënësit do të pajisin kazanët e mbetjeve me tabela: “Mbeturina qelqi” ose “Mbeturina plastike”, etj.

- Nuk do të hidhet asnjë bateri në kazanet e mbetjeve, por do të dorëzohen në shkollë dhe pastaj do të grumbullohen për t’u transportuar në pikën e grumbullimit në qytetin e Pogradecit.

- Do të grumbullohen gjithashtu në shkollë edhe mbetjet metalike, si kanoçe alumini, etj. të cilat do të transportohen në pikën e grumbullimit në Pogradec, nën përgjegjësinë e drejtuesve të shkollës.

- Mbetjet letër do të riciklohen nga vetë nxënësit në formën e tophave të letrës sipas modelit “tulla prej letre” të shpërndara nëpërmjet fletëpalosjeve.

- Mbeturinat organike si: lëkura perimesh, etj. do të depozitohen në një gropë në oborret e shtëpive për t’u përdorur si pleh organik më vonë.

- Asnjë mbeturinë nuk do të hidhet jashtë kazaneve të mbetjeve.

- Drejtuesit e shkollës Bledar Lenja dhe Florent Çela, kontaktuan me drejtues të komunës dhe kryeplakun e fshatit për t’u angazhuar plotësisht dhe në vazhdimësi, për të bërë të mundur zbrazjen e kazaneve të mbeturinave pa i përzier ato. Ky do të jetë hapi i parë i kësaj nisme që do të vazhdojë të ndiqet gjatë gjithë vitit shkollor.



Një ditë vjeshte në Pogradec

Pogradeci, ky qytet buzë liqenit të Ohrit, është ndoshta ky një vend ku çdo njeri mund ta prekë natyrën, ta shijojë atë dhe të bëhet pjesë e saj.

Një qytet në juglindje të vendit, ku e reja dhe e vjetra, modernia dhe tradicionalja bashkëjetojnë pranë e pranë, pa e cënuar njëra-tjetrën.

Këtu çdo stinë mirëpritet nga njerëzit pogradecarë dhe ka lezetin e saj. Edhe vjeshta, një stinë që duket se ka mbizotëruar edhe në këtë qytet. Çdo gjë ka marrë një pamje tjetër dhe mund të them që kudo mbizotëron qetësia e cila rrallëherë thyhet nga zërat gazmorë të njerëzve apo nga ndonjë festë.

Kudo, ngado që hedh hapat mund të shohësh rrugë të zbrazëta, pemë të zhveshura, njerëz nëpër lokale duke konsumuar diçka të ngrohtë, mungesa e diellit dhe prania e reve, çadra shiu, nxënës që nxitojnë për të kapur orët e mësimi...

Një vjeshtë që duket se ka ardhur më furishëm se vitet e tjera ku erërat e ftohta rrallëherë shoqërohen nga vetëtimat e breshëri dhe shirat e vazhdueshëm paralajmërojnë një dimër të gjatë dhe të ftohtë.

Ja pra qyteti i mbuluar nga nje numër i pafund gjethesh ka marrë një pamje të bukur piktoreske.

N.q.s doni të shihni një bukuri të natyrës, Pogradeci është një mundësi e mirë vërtet, n.q.s doni të shihni një mrekulli të natyrës, Pogradeci është një mundësi që nuk duhet humbur.

Një vend ku çaji ngroh shpirtin e njerëzve mes gjetheve të rëna.

Klediana Gjyli

Bashkëpunimi ndërkuftar vazhdon...

(Vizitë e një grupit të rinjsh në ambientet e shoqatës "Unë, Gruaja")

Ditën e premte, në datën 30 gusht, një grup të rinjsh nga Korça dhe Maqedonia vizituan ambientet e shoqatës "Unë, Gruaja". Të rinjtë bashkëbiseduan lidhur me pikëpamjet e tyre për punën në organizata nisur nga eksperiencat personale.

Stafi i shoqatës i njohu me një historik të shkurtër, me misionin si dhe projektet më të spikatura dhe me më tepër interes për komunitetin dhe të rinjtë veçanërisht. Pyetjet dhe sugjerimet ishin një pjesë tjetër e rëndësishme e kësaj vizite. Një çështje me interes që u diskutua gjatë këtij takimi ishte roli i shoqatave në përmirësimin e situatës së grave në shoqëri.

Rastet e grave të dhunuara, nismat konkrete që janë marrë për to si dhe ligji për barazinë gjinore. Të rinjtë sollën në vëmendjen tonë edhe situatën aktuale në Maqedoni, bashkangjitur edhe ndryshimet në ligj.

Shoqata UG bëri të njohura eksperiencat e saj lidhur me shtysat në ndihmë të gruas si dhe kontributin që ka dhënë në pozicionimin e saj në politikë dhe në çdo fushë të jetës sociale, ekonomike dhe kulturore. Pas bashkëbisedimit grupi i të rinjve u largua me një ndjesi të mirë dhe me dëshirën e madhe për të bashkëpunuar në të ardhmen me shoqatën "Unë, Gruaja".

Blerina Qose



Qyteti im vuan nga betonizimi...

Për herë të parë në jetën time po gjykoj me sytë e një vogëlusheje që kërkon të shohë përsëri gjithçka siç ka qënë vite më parë.

Të shohë tek rrezet e diellit depërtojnë një përzierje ngjyrash në dhomën e saj, të pasqyruara në mënyrë ëngjëllore në kontrast me nënën natyrë, që ishte aty jashtë...gjithmonë pranë saj.

Nuk dua që ky peizazh, ky moment të dergjet në sytë e saj, si një enderr që dikur e ka jetuar, por tani jo më. Pse? Vallë ku mbeti ai vend? Ç' barrë mban mbi supe? Jam lodhur nga kjo kohë...kur marr guximin të shoh nga dritarja me shpresën se do të shoh atë që dua, pavarësisht se ajo që shoh më zhgënjën.

Koha ikën duke vrapuar dhe unë mundohem ta kap atë duke ecur, gjithmonë duke pritur të vijë momenti tek sytë e mi përqafojnë atë ç'ka ka nevojë.

Nëse do të mund të bëja diçka tashmë do të isha atje, atje ku dëshira do të më kishte shtyrë me gjithë gravitetin e saj.

Përpara kam një armik gjigand që mundohet të hyjë e të gërmojë thellë brenda meje, për t'i krijuar mosbesim këtij këndvështrimi...diçka që kërkon të më thotë...

Do të më bindë se ajo që kam nevojë nuk është ajo që dua, por jo, unë jam e bindur, e di ku buron arsyeja e asaj që dua t'ia arrij qëllimit patjetër.

Dua të rilind qytetin tim...ah sikur ta kisha forcën që me një gusht të mund të rrëzoja gjithë këto kala pa kripë, të ngritura vend e pa vend në kurriz të kësaj mrekullie.

Mbyll sytë e nis të pikuroj në të bardhë atë që ky vend mundohet të më thotë në ëndërr.

Dhe ja më në fund arrita t'ia jap një imazh asaj që vërtet dua t'ia fal këtij qyteti. Shoh në një rën anë shpresa në formë valësh që një herë prekin bregun e më pas përsëri kthehen për në drejtime të tjera shpëtimi, në anën tjetër besimin që fryn furtunë për rrugëdalje, rrezet e diellit tek ngushëllojnë ndopak këtë mjerim të vobektë dhe në fund të dëgjoj larg e më larg një jehonë që sa vjen mbytet e ngjiret për ndihmë, ah aty qëndronte i burgosur vendi im.

E pra qyteti im, këtë pikërisht doja të thoja, shpreso, ki besim dhe mos e lër erën e çimentos të murosë lotët e tua!

Asja Leka

Italianët

Është mirë të mësosh dhe të marrësh vesh se përtej asaj toke, përtej atij deti, përtej atij kontinenti, ka njerëz të cilët ndajnë të njëjtin pasion me ty. Nuk e di nëse më ka prekur vetëm mua apo të gjithë grupin, por duhet thënë se atë ditë kur na lajmëruan që disa italianë donin të takoheshin me grupin e monitorimit, diçka... diçka ishte ndryshe! Nuk e di, por në njëfarë mënyre u ndjeva i vlerësuar. Ka shumë njerëz që mund të pyesin se si mund të ndjehesh i vlerësuar nga dikush që as nuk e ke takuar ndonjëherë.

Sigurisht që njoftimi për këtë ishte pak i papritur, por përsëri kjo nuk e bëri atë më pak të rëndësishëm se takimet e tjera që kishim zhvilluar.

Kur më dëgjoi veshi për fjalën 'italianë' mendova menjëherë fillimisht se mbase ishin shqiptarë që jetonin dhe punonin në Itali dhe tani nëpërmjet një projekti donin të na njihnin më mirë. Por jo, e kisha shumë gabim. Mbase mend çdo aspekt të atij takimi. E mbase mend frikën që patëm t'u flisnim atyre "të panjohurve" në fillim. Por

çfarë rëndësie ka kjo tani? E rëndësishme është që u takuam. Ishte një kënaqësi shumë e madhe të takojë njerëz që ndajnë të njëjtin pasion me ty në këtë botë. Sigurisht që kam takuar edhe të huaj të tjerë në jetën time kur kam qënë në projekte të ndryshme, por kjo ishte hera e parë kur më ra rasti të takojë njerëz që e kishin me kaq pasion punën që bënin. Kjo dallohej mjaft qartë, pasi ata ndodheshin aty. Kishin udhëtuar që nga një komunë e Italisë, në një vend të vogël si Shqipëria. E kush do ta bënte këtë nëse nuk do të kishte sadopak pasion?

Ishte një kënaqësi e madhe të takojë Françeskon, Françeskën, Sandrën dhe të gjithë grupin. Të qëndroje aty dhe të flisje me një grup të cilin e kishe takuar vetëm një herë në jetë, nuk e di, por sikur ndryshoi diçka brenda meje. Nëse të gjitha herët që ky grup monitorimi është mbledhur, mbase unë mund të kem qënë paksa i



pasigurtë për atë që bëjmë, për atë që po bëja unë në një projekt të tillë, tani jam i sigurtë. Pas atij takimi diçka më ndryshoi. Nuk e di, por diçka nga ajo bisedë e ka ndryshuar atë kendvështrimin tim mbi botën.

Misioni i tyre, misioni që ata kishin ndërmarrë, më tërhoqi vëmendjen shumë. Njerëz të cilët shkojnë nëpër qoshet më të errëta të Italisë për të ndihmuar njerëz të varfër, të droguar dhe në kushte shumë të vështira jetese, më bëri të kuptoj që ne të gjithë jemi egoistë. Unë mund të jem egoisti më i madh në atë dhomë. Dua të them, ndonjëherë, ne nuk ndihmojmë as miqtë tanë kur ata kanë vërtet nevojë. Është një

mision tepër fisnik dhe për më tepër ata janë njerëz shumë fisnikë.

Mund ta quaj veten si të dua, por përsëri asnjë prej nesh në atë grup monitorimi nuk do të krahasohej me ta. Por mbi të gjitha kjo është arsyeja se pse këtë vit shkollor, i cili do të jetë i fundit në këtë vend monoton, jam duke u menduar

që ta plotësoj me evente dhe me projekte sa më të mëdha që mundem.

Disa javë më vonë, erdhën përshtypjet e grupit italian për atë që kishin dëgjuar dhe kuptuar për ne, por edhe për atë që mendonim ne. Kishte nga ata që adhuronin projektin që ishim duke bërë, disa prej tyre ende nuk u kishte ikur ajo dëshira e bërjes së tullave...

Mbi të gjitha, është një vlerësim për atë që po bëjmë. Është një votë më shumë se ajo që jemi duke u përpjekur të ndërtojmë, tani nuk është e kotë dhe nuk është një vlerësim nga ata që besojnë tek ajo që po bëjmë.

Andi Shkëmbi

Reforma Kundër Teje

Kështjella ime është ngritur nga shtylla të holla besimi dhe është ndërtuar nga mure që rrëzohen vazhdimisht. E sa herë që mundohem ta rindërtoj këtë kështjellë, nuk arrij... Është gjithmonë diçka që më pengon, që më pret rrugën e fundos shpresat e mia në greminën e ëndrrave të humbura...

Më thuaj pra, a mundesh ti të më ndihmosh?

A je aq guximtar sa të shkosh atje, t'i marrësh ëndrrat e shpresat e njerëzve e t'ua kthesh? Po të paktën shpresat e mia? Nëse jo, atëherë mos më thuaj se do të më ndihmosh. Se ti je thjesht një krijesë si ata, si gardiani i robërisë time, që bën gjithçka për interesat e tua. Po ti?! Kush je ti?! Ti nuk je as gjaku im e as gjaku i gjakut tim. E kush të jep të drejtën ty të shkelësh ëndrrat e mia e të poshtërosh besimin tim?! Ti s'meriton as ferrin...

Po, tani do ta them e do të bërtas me të madhe: "Ty as djalli s'te pranon"! se unë nuk jam prona jote, ti s'ke paguar asgjë me vlerë. Kujton se jam një trofe në duart e tua, edhe sikur të isha një trofe, je shumë, po shumë larg fitimit të këtij trofeu.

Ti më bën të qaj për pesë orë e për pesë minuta më kërkon falje. Sa qesharake... kujton se një buzëqeshje e shtirur sipërfaqësore do të zhdukë dhimbjen, jo, thjesht acarën më shumë situatën. Mos

premtu fluturime në qiellin e shtatë, se ne të dy vetëm në tokën e errësirës së ngrirë mund të fluturojmë së bashku. Por nuk e aprovoj fluturimin tonë, se nuk i bashkangjitem botës tënde të neveritshme të mendimit se vetëm ti ke të drejtë edhe kur gabon.

Që sot unë bëj reformacion, do të ndryshoj thelbësisht pozitën tonë, ku ti ke të drejtë për çdo gjë, e unë jam një lule e brishtë që nuk lejon as t'i marrin erë, por që ti je i gatshëm ta këpusësh e të zbehësh bukurinë e saj.

Ti prish çdo moment që je betuar të zbkurosh, madje s'më lejohet as të qaj në prezencën tënde sepse në sytë e tu kjo është dobësi. S'është aspak dobësi, edhe ti mund të qash, të kam parë të qash, të kam parë edhe t'i fshehësh lotët që unë mos kujtoj se je i dobët, por s'është aspak dobësi. Në fund të fundit ti je thjesht një kafshë e mësuar me një sjellje e s'di të bëjë ndryshime.

Po e bëj unë ndryshimin, le të marrë kjo reformë emrin tim, se ky emër është i gatshëm të bëhet zëri i çdo femre në botë për të Ndaluar Dhunën...

E pse duhet të më vijë keq për ty kur ty s'te erdhi keq për mua?!

Ti sot kërkon mëshirë, mëshirën që deri dje nuk e pranoje, por unë përsëri jam këtu për ty, se jam njeri, e të konsideroj njeri... E s'jam askush për të të ndëshkuar, për mua ka një Zot, ndërsa për ty nuk e di se ku dhe nga kush do e marrësh ndëshkimin tënd...

Greta Bakollari

BOTIME TË SHOQATES “UNË, GRUAJA” - POGRADEC



Buletinet e botuara në kuadër të projektit “Të sjellim ndryshim”



SUPLEMENT I GAZETËS NOSITI NGA GRUPI MONITORUES I TË RINJVE
POGRADEC, DHJETOR 2013

“Gjithçka në një vend demokratik fillon me lejen nga publiku dhe ekziston nga miratimi publik. Nëse kjo është e vërtetë, do të duhet që institucionet (publike ose jo) duhet me kënaqësi t'i përgjigjen publikut dhe tyre, çfarë ata janë duke bërë dhe çfarë shpresojnë të bëjnë për t'u shërbyer sa më mirë atyre. Kjo praktikë është një obligim.” Arthur W. Page.

- ALEGORIA E QEVERISJES SË MIRË DHE E QEVERISJES SË KEQE faqe 2
- PROJEKTI “ANGAZHOHU-MONITORO VEPRO” faqe 3
- VULLNETARIZMI, NJË HAP MË TEJ DREJT DIJES! faqe 4
- REDUKTO - RIPERDOR - RICIKLO faqe 5
- BASHKËPUNIMI NËRKUFITAR DHE MË TEJ faqe 6
- TA PASTROJMË SHQIPËRINË NË NJË DITË faqe 7
- 16 DITË AKTIVIZËM KUNDËR DHUNËS NDAJ GRAVE faqe 8




Në këto buletine trajtohen temat:

- Ligji për “Mbrotjtjen nga diskriminimi”
- Mite dhe Fakte rreth Homoseksualitetit
- Diskriminimi në Shqipërinë postkomuniste
- Thënie të famshme për NDRYSHIMIN
- Çfarë është BULLIZMI?
- Roli i mësuesve për t'i thënë stop Bullizmit!
- Reagimi ndaj gjuhës homofobike
- Një letër Babagyshit...
- Thënie të famshme kundër BULLIZMIT.

Nuk kishte si të mungonte edhe vëmendja ndaj prindërve, të cilët përballen me një realitet kaq të vështirë. Një nga buletinet jep këshilla dhe informon prindërit që të shohin me sy pozitiv situatën me fëmijën e tyre.

Ai trajton tema si:

- Si mund ta mbështes unë fëmijën tim?
- Ndhimë! Fëmija im është...
- A do të izolohet fëmija im? A rrezikon të sulmohet fizikisht? Etj.
- Ndhimë! Fëmija im është...
- Familja shqiptare përballë realitetit homoseksual.



Ky manual përmban gjithë ekspertizën e grumbulluar gjatë dy viteve të fundit nga bashkëpunimi i shoqatës “Unë, Gruaja” me përfaqësues të Mekanizmit të Referimit dhe Trajtimit të Rasteve të Dhunës në Familje në qytetin e Pogradecit:

- Si funksionon ky Mekanizëm për rastet e dhunës në familje;
- Rolet dhe përgjegjësitë e institucioneve pjesë e MR;
- Mbarëvajtja e sistemit të referimit të rasteve tek njëri-tjetri;
- Raste konkrete të trajtuara nga institucione të ndryshme;
- Problemet e hasura, nevojat, rekomandimet.

Në kuadër të projektit “Një sy për mjedisin”, u botua fletëpalosja “Redukto - Ripërdor - Riciklo”